

VENDIM
Nr. 656, datë 26.9.2012

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI, PRONËSIA, SHFRYTËZIMI, MIRËMBAJTJA DHE TRANSFERIMI NË FAVOR TË SHTETIT TË PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi në favor të shtetit të projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë objekte, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 278 146 846.8 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë pikë tetë) lekësh.

4. Fondi prej 278 146 846.8 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë pikë tetë) lekësh të përballohet nga fondet e “Devoll Hydropower” sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 12 360 000 (dymbëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga “Devoll Hydropower” sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.10.2012.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bashkëpunim me shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Elbasan, Gramsh dhe Korçë, në bashkëpunim me shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a., brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të projektit në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara, në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Elbasan, Gramsh dhe Korçë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohen procesi i hedhjes së trupit të projektit në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Elbasan, Gramsh dhe Korçë dhe shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha